



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 34/2021

Nr. Protokolli: 49/2021

Për:	Naim Sopaj B.I. NNP "Sopi"
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	27.04.2021



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 26.04.2021 të paraqitur përmesë E-mailit nga Operatori Ekonomik: **Naim Sopaj B.I. NNP "Sopi"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Projekt me bashkëfinancim Ndërtimi i rrugës Gjinoc -Novakë -Mamushë"** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1472-5-2-1 & 624-021-068-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Hedhet Poshtë si e pas afatshme** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 26.04.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"Naim Sopaj B.I. NNP "Sopi"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Projekt me bashkëfinancim Ndërtimi i rrugës Gjinoc -Novakë -Mamushë"** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1472-5-2-1& 624-021-068-521**
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 26.04.2021 përmesë e-mailit ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik **Naim Sopaj B.I. NNP "Sopi"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Projekt me bashkëfinancim Ndërtimi i rrugës Gjinoc -Novakë -Mamushë"** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1472-5-2-1& 624-021-068-521**, për kriteret e vendosura nga AK.

Kërkesa për ri-shqyrtim është paraqitur pas afatit të paraparë me dispozita ligjore, konkretisht me nenin 4, paragrafi 4.1 tek Rregullat për Parashtrim të Ankesave të nxjerruar nga KRPP. Kjo pasi që hapja e tenderit është me date 30.04.2021, dhe afati për pranimin e kërkesave për sqarime ka qenë deri me 23.04.2021 ndërsa ju keni parashtruar kërkesën me date 26.04.2021.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

